

V E N D I M
Nr.445, datë 26.6.2003

PËR INSPEKTIMIN E PUNËS SË DETARËVE

(Ndryshuar me VKM nr.639, datë 20.9.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Inspektimin e kushteve të punës së personave të punësuar, në çdo detyrë, në anijet detare.
2. Inspektimi të bëhet në anijet, rimorkiatorët e detit dhe anijet e peshkimit, të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, si person fizik a juridik, vendas a i huaj, që ka si qëllim transportin e pasagjerëve e të mallrave apo qëllime tregtare.
Bëjnë përjashtim nga ky vendim anijet platforma shpimi ose shfrytëzimi, kur nuk përdoren për lundrim.
3. Të gjitha anijet e regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, të inspektohen nga Inspektorati Shtetëror i Punës i rrethit përkatës në intervale kohe jo më të gjata se 3- vjeçare edhe, kur është e mundshme 1-vjeçare.
4. Inspektorati Shtetëror i Punës të jetë organi që ushtron kontroll për zbatimin e legjislacionit të punës në të gjitha mjetet e lundrimit, të përmendura në pikën 2.
5. Inspektorët e punës, të pajisur me dokumentacionin përkatës identifikues, kanë të drejtë:
 - a) të hyjnë në portet detare, në portet e ujërave të brendshme, në bordin e anijes së regjistruar dhe në mjediset e brendshme për inspektim;
 - b) të shqyrtojnë, të kontrollojnë ose të organizojnë anketa, kur e gjykojnë të nevojshme, për t’u siguruar për respektimin e dispozitave ligjore; kur vërejnë shkelje dhe mangësi përcaktojnë detyra për shmangien e tyre;
 - c) të mos lejojnë lëvizjen e mjeteve nga porti, kur vërejnë shkelje të rënda të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë të shëndetit e të jetës së detarëve.
6. *Personat, juridikë a fizikë, të përcaktuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, në dokumentacionin që depozitojnë në Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për t’u licencuar apo rilicencuar duhet të kenë edhe dokumentin e regjistrimit në Inspektoratin Shtetëror të Punës të rrethit përkatës.*
7. *Ngarkohen Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Brendshëm për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.*
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano